

VENDIM
Nr.386, datë 19.6.2004

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË MJEDISIT TË DEGËVE
TË MOBILIZIMIT NË QYTETET PËRMET DHE TEPELENË, TË CILAT JANË NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES, DHE PËR DISA
NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT Ë MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË
SË MBROJTJES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “c” të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjedisëve të degëve të mobilizimit në qytetet Përmet dhe Tepelenë, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, t’u ndryshojë përgjegjësia e administrimit dhe të kalojë te prefekti i qarkut të Gjirokastrës, për t’u përdorur për sistemimin e stacioneve të PMNZSh-së në këto qytete.

2. Pronat me numrat rendorë 652 “Dega e mobilizimit”, Përmet dhe 662 “Dega e mobilizimit”, Tepelenë, me të gjitha elementet përbërëse, të hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Prefektit të qarkut të Gjirokastrës, i ndalohet t’ua ndryshojë destinacionin pronave të përcaktuara në këtë vendim, t’i tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, Ministri i Ekonomisë, prefekti i qarkut Gjirokastrë dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano